



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 2766/41 Prot.

Tiranë, më 1/12 /2021

URDHËR

Nr. 29/1, datë 1.12 2021
PËR

EMËRIMIN DHE MANDATIMIN E KRYETARIT DHE ANËTARËVE TË BORDIT TË
MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pika 3, neni 4 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe pikës 1 të Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

- Emërimin e kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si më poshtë:
 - Z. Dritan **FINO**, propozuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, përzgjedhur nga Institucionet e Arsimit të Lartë;
- Emërimin e anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si më poshtë:
 - Znj. Adriana **BERBERI**, propozuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
 - Z. Luan **ABAZI**, propozuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
 - Z. Martin **MICI**, propozuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë;
 - Z. Gjergji **DURO**, propozuar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, pranë Kuvendit të Shqipërisë;
- Mandati i emërimit të Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike është 4 (katër) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
- Ngarkohet Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

